

Pyetjet më të shpeshta

Thirrje për Propozime: "Recraft the Past: Build Up the Future 3"

ALB/EC/22644/CFP 05-2024

I. Kriteret e lejueshmërisë

P1. A janë të lejueshme kompanitë publike lokale për mbështetje sipas kësaj Thirrje për Propozime?

Kompanitë Publike Lokale nuk kanë të drejtë për mbështetje sipas kësaj Thirrje.

P2. A lejohet të mbështen individët në këtë Thirrje për Propozime?

Aplikantët individualë të cilët nuk janë të regjistruar si një organizatë jofitimprurëse ose një lloj tjetër organizate e pranueshme (p.sh. si një institucion akademik), nuk kanë të drejtë për mbështetje sipas kësaj Thirrje. Megjithatë, ata mund të angazhohen si partnerë të asociuar të një projekt-propozimi ose si konsulentë të jashtëm (ekspertë).

P3. Përveç subjekteve të përmendura në Thirrjen për Propozime (organizata jofitimprurëse), a munden kompanitë private të biznesit, duke përfshirë kompanitë e konsulencës, të cilat ofrojnë shërbime në fushën e artit, artizanatit dhe kulturës, turizmit, konsulencë për biznese start-up etj. të konsiderohen të pranueshme për mbështetje Granti?

Organizatat që mund të jenë aplikantë dhe/ose partnerë në këtë Thirrje për Propozime duhet të kenë të përcaktuar që janë entitete jofitimprurëse në Aktin e tyre të Regjistrimit në Gjykatë dhe ato duhet të plotësojnë kriteret e tjera që aplikimet e tyre të merren parasysh për vlerësim. Kompanitë e konsulencës që ofrojnë mbështetje për subjekte të tjera fitimprurëse ose jofitimprurëse mbi baza tregtare, mund të angazhohen vetëm si partnerë të asociuar në fazën e aplikimit. Këto subjekte mund të angazhohen edhe si ofrues shërbimesh gjatë zbatimit.

P4. A mund të jetë një Institucion i Arsimit të Lartë aplikant sipas Thirrjes për Propozime? A është e lejueshme për mbështetje një Qendër për Zhvillim Profesional (e regjistruar për kërkime dhe edukim)?

Organizatat akademike kanë të drejtë të aplikojnë për aq kohë sa janë të regjistruara ligjërisht si organizata **jofitimprurëse** dhe përmbushin kriteret e tjera të Thirrjes për Propozime.

P5. A mund të aplikojë një organizatë një herë si aplikant kryesor dhe njëherë si partner?

Jo. Një organizatë duhet të jetë ose aplikant kryesor ose partner në këtë Thirrje për Propozime.

P6. A mund të marrë pjesë një Bashki në një aplikim si partner?

Bashkitë, si institucione qeveritare, nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në këtë Thirrje për Propozime si aplikantë apo partnerë. Megjithatë, ato mund të angazhohen si partnerë të asociuar. Angazhime të tilla të shprehura brenda aplikimit, ndërmjet aplikantit dhe këtyre institucioneve mund të konsiderohen si kontribut në rritjen e qëndrueshmërisë së projektit dhe mund të ndikojnë pozitivisht në rezultatin e vlerësimit të projekt-propozimit.

P7. A duhet të jetë organizata partnere shqipëtare?

Organizatat partnere duhet të jenë të regjistruara në Shqipëri, në përputhje me ligjin shqiptar.

P8. A duhet që organizata aplikuese të jetë nga një prej bashkive të përcaktuara në Thirrjen për Propozime?

Organizata aplikuese nuk duhet të dëshmojë praninë ose përvojën e drejtpërdrejtë në territorin administrativ të bashkive të përcaktuara në Thirrjen për Propozime. Prezenca ose përvoja e ngjashme (të kaluara ose aktuale) janë të rekomandueshme, por jo të domosdoshme.

II. Buxheti dhe Bashkëfinancimi**P9. A konsiderohen shpenzimet e marrjes me qira të një zyre si kosto operative?**

Po. Kostot operative përfshijnë koston e marrjes me qira të një hapësire pune dhe si të tilla nuk janë kosto të lejueshme. Ato mund të parashikohen dhe përfshihen në buxhet vetëm si kontribut bashkëfinancues i aplikantit. Nëse ky do ishte rasti, palës bashkëfinancuese do t'i kërkohej të paraqesë dëshmi të pagesës së qirasë si pjesë e raporteve financiare.

P10. A është i detyrueshëm bashkëfinancimi sipas kësaj Thirrje për Propozime?

Jo. Bashkëfinancimi nuk është i detyrueshëm.

P11. Tavani i kostove të lejuara të stafit prej 25% të kostos totale të projektit të buxhetit përfshin vetëm shpenzimet e personelit të projektit apo të gjitha burimet njerëzore?

Tavani i përgjithshëm i kostove të personelit (Kategoria: buxheti i personelit) përfshin kostot e pranueshme për ekipin e projektit që do të përfshihet vazhdimisht gjatë gjithë zbatimit të projektit nëpërmjet kontratave të punës me organizatën zbatuese.

P12. A mund të përdoret bashkëfinancimi i organizatës për financimin e pagave të punonjësve?

Pagat e stafit janë pjesë e kostove të personelit për ekipin e projektit, prandaj ato nuk duhet të kalojnë 25% të buxhetit total të projektit. Organizatat që janë angazhuar për bashkëfinancim, mund ta përdorin atë në koston e personelit nëse totali i kësaj kategorie nuk kalon 25% të buxhetit total.

P13. A mund të konsiderohet kostoja e qirasë së një hapësire për aktivitetet e ngritjes së kapaciteteve si një bashkëfinancim brenda buxhetit të projektit?

Marrja me qira e hapësirave për aktivitete specifike të lidhura me projektin jashtë zyrave të organizatës mund të përbëjë bashkëfinancim të lejueshëm. Megjithatë, nëse e njëjta hapësirë përdoret gjithashtu si hapësirë zyre nga aplikanti ose organizata e tij partnere, kostot e qirasë nuk do të pranohen si bashkëfinancim brenda buxhetit të projektit.

P14. A mund të përfshihet blerja e ambienteve të punës në buxhetin e projektit?

Jo, blerja e ambienteve të punës nuk është një kosto e pranueshme sipas kushteve të kësaj Thirrje për Propozime.

P15. Në Thirrje thuhet se shuma maksimale e një granti është 50,000 USD. A do të thotë kjo se financimi nga EU4Culture në total mund të jetë 50,000 USD apo përfshin edhe bashkëfinancim?

Shuma maksimale e një granti - 50,000 USD do të thotë që EU4Culture mund të financojë në koston e përgjithshme të projektit deri në këtë vlerë maksimale të deklaruar të grantit.

III. Qëllimi

P16. A duhet t'u përgjigjen projektet e propozuara të dy objektivave specifike të kësaj Thirrje për Propozime?

Jo domosdoshmërisht. Të gjitha projektet nën këtë Thirrje duhet të kontribuojnë drejtpërdrejt në arritjen e objektivit të përgjithshëm nëpërmjet aktiviteteve që synojnë arritjen e objektivit të parë ose të dytë OSE të të dyve së bashku.

P17. A duhet t'u përgjigjen projektet e propozuara të dyja temave kryesore të kësaj Thirrje për Propozime?

Jo domosdoshmërisht. Të gjitha projektet nën këtë Thirrje duhet të kontribuojnë drejtpërdrejt në arritjen e objektivit të përgjithshëm nëpërmjet aktiviteteve që synojnë të arrijnë njërën nga temat ose të dyja.

P18. A është e justifikuar apo jo përfshirja në aktivitete me prodhuesit e pijeve alkoolike të cilët janë të regjistruar për të prodhuar verë, birra, raki dhe pije të tjera alkoolike?

Aktivitetet që lidhen me prodhuesit e pijeve alkoolike nuk mbështeten nga kjo Thirrje për Propozime. Aktivitetet që lidhen me prodhuesit e regjistruar për përpunimin e frutave (por jo të regjistruar për të prodhuar pije alkoolike) mund të jenë të lejueshme për mbështetje sipas kësaj Thirrje për Propozime.

P19. A duhet propozimi të adresojë të gjitha bashkitë e specifikuar në Thirrjen për Propozime?

Projekt-propozimet pritet të përfshijnë projekte të cilat duhet të kontribuojnë drejtpërdrejt në arritjen e objektivit të përgjithshëm dhe të secilit prej objektivave specifik në një, disa ose të gjitha territoret e bashkive të përcaktuara në Thirrjen për Propozime.

P20. A mund të lidhen aktivitetet e projektit të propozuar me aktivitete të tjera në vazhdim të organizatës?

Aktivitetet mund të pasojnë ose të lidhen me projekte të tjera. Megjithatë, fondet nga kjo Thirrje për Propozime nuk mund të përdoren për aktivitete tashmë të financuara nga burime të tjera financimi, të cilat nuk janë ose nuk do të jenë pjesë e marrëveshjes së mbështetjes së grantit me UNOPS.

P21. A mund të aplikojnë organizatat të cilat kanë zbatuar projekte të financuara nga thirrjet e mëparshme të EU4Culture?

Organizatat që kanë zbatuar dhe përmbyllur (operativisht dhe financiarisht) projekte të financuara nga thirrjet e mëparshme të publikuara nga EU4Culture kanë të drejtë të aplikojnë.

P22. A mund të zgjatet kohëzgjatja e përgjithshme e një projekti të financuar nga kjo Thirrje për Propozime për të adresuar ndonjë sfidë të papritur që mund të lindë gjatë zbatimit?

Kohëzgjatja e zbatimit të projekteve që do të financohen sipas kësaj Thirrje për Propozime, në asnjë rast nuk mund të zgjasë përtej afatit kohor të shënuar në Thirrjen për Propozime (Seksioni "Particulars"). Çdo

risk i brendshëm ose i jashtëm që parashikohet se mund të lindë gjatë zbatimit duhet të shtjellohet në propozim së bashku me masat përkatëse.

IV. Procedura e aplikimit

P23. A mund të plotësohet dhe dorëzohet formulari i aplikimit në gjuhën shqipe?

Formularët e aplikimit duhet të plotësohen dhe dorëzohen vetëm në gjuhën angleze. Megjithatë, ato dokumente mbështetëse që lëshohen nga autoritetet shqiptare (siç specifikohet në Thirrjen për Propozime) do të pranohen në gjuhën shqipe.

P24. A mund të dorëzohet aplikimi në version të printuar me postë?

Jo. Aplikimet do të pranohen vetëm në format elektronik, dorëzuar në e-mailin e shënuar në Thirrjen për Propozime.

P25. A duhet të dërgojnë të gjithë anëtarët e ekipit të projektit të listuar në aplikim CV-të së bashku me aplikimin?

Formulari i aplikimit duhet të përfshijë informacion të detajuar për të gjithë anëtarët kryesorë të ekipit. Ky informacion duhet të plotësohet brenda Shtojcës A-Propozimi sipas kërkesave të formatit dhe të dorëzohet vetëm nga aplikanti. CV-të në formate të tjera nuk do të pranohen si pjesë e aplikimit, qoftë të dorëzuara nga aplikanti apo nga një palë tjetër.